



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

dt.15.07.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “Ernest Shira” pf

**Adresa: Tirane Rruga Irfan Tomini, Ndertese private ne Zonen Kadastrale 8260 me Nr.Pasurie
2/163 1001**

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Blerje pajisje dhe vegla pune” për nevoja të Qendrës së Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit “Tirana” me Nr REF-99522-06-29-2021** për nevoja të Qendrës së Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit pasi kjo qëndër kryen mirëmbajtjen, pastrimin dhe restaurimin e veprave ekzistuese në territorin e Bashkisë Tiranë, si dhe çdo funksion tjetër të përcaktuar në rregulloren e saj të organizimin dhe funksionimit.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Buletini Nr. 104 datë 5 Korrik 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1 Operatori ekonomik “Ernest Shira” pf

NUIS L82301006Q

Vlera e ofertës pa TVSH– 1.949.500 (një milion e nëntëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind) lekë

2 Operatori ekonomik ”Luar Bros” shpk NUIS: L72322004M

Vlera e ofertës pa tvsh = **2.001.300** (dy milion e një mijë e treqind) lekë.

3. Operatori ekonomik ”Muca” shpk NUIS: K01421002H

Vlera e ofertës pa tvsh = **2.011.600** (dy milion e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1 Operatori ekonomik ”Luar Bros” shpk NUIS: L72322004M

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, dhe Kreut VII, neni 82, pika 2 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga kjo shoqëri, nga ku rezultoi si më poshtë:

2. AK ne dokumentat standarte te tenderit dhe konkretisht nëkriterin 2.3.3 tek rubrika “Kapaciteti teknik” ka kërkuar shprehimisht se:

“Operatori ekonomik duhet te paraqesi skedën teknike për artikujt Nr. 1, 2, 3, 8, 9, 19, 21, 22, 23, 25 në të cilën të gjëjnë pasqyrim specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Skedat teknike duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe » .

1. Komisioni i Vlerësimit të ofertave pas verifikimit të bërë skedave teknike për zërat *Nr. 1, 2, 3, 8, 9, 19, 21, 22, 23, 25* konstaton si më poshtë vijon:

1. Përsa i perket zërit “Vidator me 2 bateri” vërehet se në detajet teknike nuk është përfshirë :

- Efikasiteti i energjise ne ngarkese
- Numri i rrotullimeve në bosht
- Shkalla e goditjes në (bpm)
- Të dhënat e baterisë dhe aksesorët e saj

2. Përsa i përket zërit “Matës me lazer” vërehet se nuk ka disa detaje apo të dhënë përsa i përket baterisë, nuk i ka të përfshirë aksesorët 1 x L4 B3 Paketë baterie, kablllo USB dhe prizë muri. Pësja e këtij artikulli në specifikimet e vendosura nga AK është 0.9 kg ndërkohë që në specifikimet e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik **”Luar Bros” shpk** pësja e këtij artikulli është 100 (g).

3. Në lidhje me zërin “Sharrë rrethore ne specifikimet e tij AK ka percaktuar se rrotullimet në minutë janë 4500 ndërkohë OE i ka paraqitur ato në masën 4100 rpm. Fuqia e energjisë e kërkuar nga AK është në masën 2200 Ë ndërkohë e paraqitur nga OE është 2000 Ë..Pësja e këtij artikulli në

- specifikimet e vendosura nga AK është 7.7 kg ndërkohë që në specifikimet e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik **”Luar Bros” shpk** pesha e këtij artikulli është 7 kg.
4. Përsa i përket zërit Sharrë seria Recipro mungojnë disa detaje teknike sikundër janë:
 - 1.Fuqia
 - 2.Norma e goditjes
 - 3.Pesha
 5. Në lidhje me zërin “Disk prerës Makita 230 V 9565CVR” vërehen se ka sërish një mospërputhje midis specifikimeve të vendosura nga AK dhe atyre të paraqitura nga ana e OE **”Luar Bros” shpk** pasi Energjia e fryrjes (EPTA) e përcaktuar nga AK është 6.1 J ndërkohë OE e ka paraqitur 8.0 J. Vibrimi në shpim nga ana e AK është kërkuar 10.6 m/s² OE e ka paraqitur 5.0 m/s². Dridhja e daltës tek specifikimet e vëna në dispozicion nga AK është 9.6m/s² OE e ka paraqitur 4.5 m/s² . Pesha e këtij artikulli në specifikimet e vendosura nga AK është 5 kg ndërkohë që në specifikimet e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik **”Luar Bros” shpk** pesha e këtij artikulli është 8.1 kg ç’ka bie në kundërshtim me specifikimet e vendosura nga AK.
 6. Në lidhje me zërin “Sharrë tavoline me disk bango” vërehet se pesha e këtij artikulli në specifikimet e vendosura nga AK është 29.5kg ndërkohë që në specifikimet e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “Luar Bros” shpk pesha e këtij artikulli është 54 kg ç’ka bie në kundërshtim me specifikimet e vendosura nga AK.

Ne nenin 80, pika 1 (a) të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet: *“Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:*

“a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura”; Në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik ”Muca” shpk

NUIS: K01421002H

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, dhe Kreut VII, neni 82, pika 2 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga kjo shoqëri, nga ku rezultoi si më poshtë:

2. AK ne dokumentat standarte te tenderit dhe konkretisht nëkriterin 2.3.3 tek rubrika “Kapaciteti teknik” ka kërkuar shprehimisht se:

“Operatori ekonomik duhet te paraqesi skedën teknike për artikujt Nr. 1, 2, 3, 8, 9, 19, 21, 22, 23, 25 në të cilën të gjëjnë pasqyrim specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Skedat teknike duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe » .

Komisioni i Vlerësimit të ofertave pas verifikimit të bërë skedave teknike për zërat Nr. 1, 2, 3, 8, 9, 19, 21, 22, 23, 25 konstaton si më poshtë vijon:

- 1. Për zërin Nr 1 “Elektrogur” nuk ka të shprehur asnjë të dhënë apo detaj përsa i përket mbrojtjes kundër goditjes. Peshë e këtij artikulli në specifikimet e vendosura nga AK është 5.8 kg ndërkohë që në specifikimet e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “Muca” shpk peshë e këtij artikulli është 6.7 kg.*
- 2. Përsa i përket zërit Nr. 2 vërehet se përsëri ka mospërputhje të specifikimeve të kërkuara nga AK me ato të paraqitura nga OE “Muca” shpk dhe konkretisht nuk ka asnjë të dhënë apo detaj përsa i përket mbrojtjes kundër goditjes. Fuqia e energjisë e artikullit të paraqitur nga OE është 1400 Ë ndërkohë sipas përcaktimit të bërë nga AK në specifikimet teknike kjo fuqi duhet të jetë 1750 Ë. Peshë e këtij artikulli në specifikimet e vendosura nga AK është 2.8 kg ndërkohë që në specifikimet e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “Muca” shpk peshë e këtij artikulli është 3.6 kg ç’ka bie në kundërshtim me specifikimet e vendosura nga AK .*
- 3. Përsa i përket zërit Nr 3 “Gur fresibël” vërehen disa mospërputhje midis specifikimeve të vendosura nga AK në dokumentat e tenderit dhe specifikimeve të paraqitura nga operatori ekonomik “ Muca “ shpk dhe më konkretisht: Peshë e këtij artikulli në specifikimet e vendosura nga AK është 3.4 kg ndërkohë që në specifikimet e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “Muca” shpk peshë e këtij artikulli është 2.5 kg cka bie në kundërshtim me specifikimet e vendosura nga AK . gjithashtu numri i dridhjeve per (m/s²) është 9.4 ndërkohë tek specifikimet e paraqitura nga OE sa më sipër cituar numri i dridhjeve per (m/s²) është 6 m/S² ç’ka bie në kundërshtim me specifikimet e vendosura nga AK. Edhe për këtë nuk ka të shprehur asnjë të dhënë apo detaj përsa i përket mbrojtjes kundër goditjes.*
- 4. Përsa i përket zërit “Vidator me 2 bateri” vërehet gjithashtu një mosrakordancë ndërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK dhe specifikimeve të paraqitura nga OE “Muca” shpk për këtë zë. Këto mospërputhje konsistojnë si më poshtë vijon:
 - 1. Për këtë nuk ka të shprehur asnjë të dhënë apo detaj përsa i përket mbrojtjes kundër goditjes.*
 - 2. Mungojnë të dhënat përsa i përket peshës së baterisë si edhe nuk ka asnjë të dhënë tjetër për baterinë.**
- 5. Përsa i përket zërit “Matës me lazer” vërehet se nuk ka asnjë detaj apo të dhënë përsa i përket baterisë, nuk ka përcaktuar ngjyrë të lazerit dhe nuk i ka të përfshirë aksesorët 1 x L4 B3 Paketë baterie, kabllo USB dhe prizë muri, Kuti mbajtëse.*
- 6. Përsa i përket zërit “Sharre me lama” vërehet se mungon tek specifikimet e paraqitura për këtë zë nga ana e OE “Muca” shpk sistemi kundër vibrimit AVS si edhe gjatësia e kordonit të ushqimit që është 4m.*
- 7. Në lidhje me zërin “Sharre rrethore ne specifikimet e tij AK ka përcaktuar se rrotullimet në minutë janë 4500 ndërkohë OE i ka paraqitur ato në masën 4100. Fuqia e energjisë e kërkuar nga AK është në masën 2200 Ë ndërkohë e paraqitur nga OE është 2000 Ë. Thellësia e preresjes e kërkuar nga AK është 67 mm ndërkohë e pasqyruar nga OE në specifikimet e paraqitura nga ana e tij është 60 mm. në vijim vihet re se mungon frenimi I shalës ndalon 3.5 sek. Peshë e këtij artikulli në specifikimet e vendosura nga AK është 7.7 kg ndërkohë që në specifikimet e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “Muca” shpk peshë e këtij artikulli është 6.7 kg.*

8. Në lidhje me zërin “Matrapik i vogël” vërehen se ka sërish një mospërputhje midis specifikimeve të vendosura nga AK dhe atyre të paraqitura nga ana e OE “Muca” shpk pasi Energjia e fryrjes (EPTA) e përcaktuar nga AK është 6.1 J ndërkohë OE e ka paraqitur 8.0 J. Vibrimi në shpim nga ana e AK është kërkuar 10.6 m/s² OE e ka paraqitur 5.0 m/s². Dridhja e daltës tek specifikimet e vëna në dispozicion nga AK është 9.6m/s² OE e ka paraqitur 4.5 m/s². Pesha e këtij artikulli në specifikimet e vendosura nga AK është 5 kg ndërkohë që në specifikimet e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “Muca” shpk pesha e këtij artikulli është 8.1 kg ç’ka bie në kundërshtim me specifikimet e vendosura nga AK.

9. Në lidhje me zërin “Matrapik i madh” konstatohen disa mospërputhje midis specifikimeve të përcaktuara nga AK dhe atyre të paraqitura nga OE si më poshtë:

-Fuqia e hyrjes (Ë) e përcaktuar nga Ak është 1750 Ë dhe në specifikimet e paraqitura nga OE rezulton 1850 Ë. Dridhja e Daltës (m / s²) nuk janë të përcaktuara në skeden teknike.

Pesha e këtij artikulli në specifikimet e vendosura nga AK është 10kg ndërkohë që në specifikimet e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “Muca” shpk pesha e këtij artikulli është 18.4 kg cka bie në kundërshtim me specifikimet e vendosura nga AK. Në vijim vërehet se mungojnë pozicionet për këndin e daltës që është kërkuar me 12 pozicione, ndërsa nga skeda teknike e juaj nuk tregon asgjë në lidhje me kërkesën.

10. Në lidhje me zërin “Sharrë tavoline me disk bango” vërehet se pesha e këtij artikulli në specifikimet e vendosura nga AK është 29.5kg ndërkohë që në specifikimet e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “Muca” shpk pesha e këtij artikulli është 54 kg ç’ka bie në kundërshtim me specifikimet e vendosura nga AK.

Në nenin 80, pika 1 (a) të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet: “Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

“a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura”; Në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Ernest Shira” pf, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **1.949.500 (një milion e nëntëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh** është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.